



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 15-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 31.01.2023, në sallën e Kuvendit, në objektin e ri të komunës me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Majlinda Sylejmani, anëtare
14. Gentianë Hoxhaj, anëtare
15. Venhar Agushi, anëtar
16. Lulzim Rustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Egzona Bytyqi, anëtare
21. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
22. Ganimete Qeriqi, anëtare
23. Alban Salihu, anëtar
24. Fitim Meziu, anëtar
25. Fadil Spahiu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Dragacina, anëtare
28. Besiana Sylja, anëtare
29. Enver Kryeziu, anëtar
30. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës për komunitete
4. Latif Ramadani DBF
5. Anila Reçica, DKRS
6. Valon Pacolli, DEZH
7. Shkelzen Hajdini, DSH
8. Flamur Sylejmani, DI
9. Elmaze Behluli, DA
10. Sead Aliu, DI
11. Rexhep Rexhepi, DBP
12. Rasim Hasani, DA
13. Safete Amerrlahu, DGJK
14. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha së pari ju kërkoj të ta nderojmë me 1 minutë heshtje për shkak se ka vdekë, profesoresha, Hajrije Salihu ish anëtare e kuvendit për kontributin e saj si profesoreshë dhe si anëtare e kuvendit. I shprehi ngushëllime familjes Salihu në emër të kuvendit Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të proceverbalit nga mbledhja e 14-të e Kuvendit.
2. Informata për punën e BKSB-së, për vitin 2022.
3. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2022, deri më 16.01.2023.
4. Propozim-vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2023-2027 (Rishikim).
5. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Kompaninë Rajonale të Mbetjeve "Pastrimi" Sh.A.
6. Propozim Vendim për lirim nga pagesa të borxheve jofitimprurëse të qirasë të përfituesve të banesave sociale.
7. Raport i punës së Komisionit për organizimin dhe koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit.
8. Deklarata e Kuvendit të Komunës në mbështetje të kërkesës së qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", që lulëkuqja me katër petale të jetë simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.

Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Gazmend Qerkini, tha se ne si grup i LDK-së, kërkojmë qe te jetë edhe një pikë shtesë në rend të ditës Rekomandim për Ministrinë e Financave dhe Transferove qe të pezullohet vendimi për rritjen e tatimit në pronë.

Lulzim Rrustemi, tha se dola qe te bëj një sqarim rreth pikave të rendit të ditës, ku dola te tregoj se anëtarët e kuvendit e komunës kanë të drejta të barabarta, qe te shtojnë pika te rendit të ditës, po ashtu mund të propozojnë për te shtyre mbledhjen e kuvendit, te plotësojnë rendin e ditës, dhe çdo kërkesë urgjente, e me rendësi publike e këto ja lejon Rregullorja e Punës së Kuvendit

Daut Azemi, tha se nuk kemi thënë asnjëherë qe nuk mundeni me shti pika te rendit të ditës, por qe te vijë një pikë në rend të ditës duhet si grup te i jepni nënshkrimet e anëtarëve të grupit.

Arsim Jashari, tha se është mirë mos me bo politika me ndjenja të qytetarëve, dhe kjo është përgjegjësi e Ministrisë, dhe mos te del qe anëtarët e kuvendit nuk po donë me ua falë nga 100 euro.

Daut Azemi, kryesues i Kuvendit tha se është është vetë rekomandim i grupit të LDK-së qe të pezullohet ky vendim i Ministrisë dhe te bëhet faturimi siç ka qenë me parë.

Kryesuesi se pari e hodhi ne votim propozimin e grupit të LDK-së, pas votimit u konstatua se Kuvendi me 26 vota për, 4 abstenime, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj e futi në votim rendin e ditës të kompletuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 25 vota për, 4 abstenime kundër aprovoi rendin e ditës..

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Arsim Jashari, tha se kam disa kërkesa të qytetarëve, e para ka të bëjë me banorët e fshatit Bujari qe kanë kërkesë, për rregullimin e rrugës mes Llugaxisë dhe Bujarisë pasi qe është në gjendje të mjerueshme te paktën te zhavorrohet. Kërkesa e dytë e dytë për familjen Ademi nga fshati Banullë, m ku ju ka aprovua kërkesa për asfaltim por nuk e di kur do te filloj. Kërkesa tjetër ka të bëjë me shportat statike te banorëve te fshatit Banulle dhe Bujari qe ato shporta te kenë kapak . Po ashtu kërkesa e banorëve te fshatit Gadime për rregullim te trotuarit me ndriçim publik dhe pengesa në rrugë. Dhe kërkesën për herë të dytë të familjes Bardhi te vazhdohet me rregullimin e shtratit të lumit në Magure pasi qe është gjendje jo e mirë . Tha për fund kam edhe një sqarim e para unë sa here qe ka pas diçka në të mirën e qytetarëve unë çdo herë i kam thirrë shefat e grupeve për te diskutuar për atë çështje, ndërsa shefi i grupit të LDK-së këtë herë nuk na ka ftuar neve për takimin e fundit për mbledhjen përkujtimore

Fadil Spahiu, tha se kam një kërkesa të banorëve e fshatit Smallushë kanë ngritur një shqetësim lidhur me punimet që janë duke u zhvilluar në shtratin e lumit të fshatit edhe pse tani për tani punimet janë ndërprerë për arsyeje të sezonit të dimrit.

Shqetësimi i banorëve është se projekti për ndërtimin e shtratit të lumit kishte filluar mirë, duke u thelluar shtrati, pastruar nga mbeturinat dhe betonizuar muret e lumit, por në pjesën e dytë të punimeve përkatësisht në pjesën që gjinden në mesë të fshatit punimet kanë vazhduar vetëm me thellimin e shtratit të lumit pa u betonizuar pjesët anësore, e që në këtë pjesë shtrati i lumit përveç se është më cekët është edhe me kthesa dhe sa edhe që ka të reshura të mëdha të shiut në ato pjesë uji del nga shtrati dhe futet në oborret dhe shtëpitë e këtyre lagjeve. Arsyeja e këtyre shqetësimeve është sepse në tabelën e ndarjes së buxhetit të shpenzimeve të komunes për vitin 2023, figuron vetëm vlera e ndarë për ndërtimin e shtratit të lumit në fshatin Smallushë, pa shpjeguar më me hollësi se si do të jetë projekti. Pra, kërkesa e banorëve të këtyre lagjeve është që të vazhdojnë me betonizimin e mureve të shtratit të lumit si në segmentin e parë që është përfunduar. Si dhe kompania që i ka kryer punët gjatë punimeve në një lagje ka dëmtuar gypin e kanalizimit dhe ende nuk e ka bërë riparimin. Ndërsa, Banorët e fshatit Gllavicë kanë bërë kërkesë që në rrugën Avduhrrahman Gashi që lidhë fshatin Gadime e Epërme me fshatin Gllavicë konkretisht në lagjen Reçica në Gllavicë të vendosen pengesa në rrugë për të ulur shpejtësinë e lëvizjes së automjeteve, sepse disa persona duke mos rrespektuar shenjat e komunikacionit me automjetet e tyre po e tejkalojnë shpejtësinë e lëvizjes dhe si pasojë e shpejtësisë së lartë dhe e kthesave të mëdha të cila janë në këtë lagje shpeshherë automjetet e tyre po dalin nga rruga dhe po futen në oborret dhe shtëpitë e banorëve të kësaj lagjeje dhe se përveç dëmeve materiale po ju rrezikohet edhe jeta në oborret e tyre banorëve të kësaj lagjeje. Banorët e kësaj lagjeje vitin e kaluar me anë të një shkrese i kanë bërë kërkesë organeve kompetente komunale për këtë çështje, por deri më tani organet kompetente nuk kanë ndërmarrë asgjë.

Nexhmedin Lekiqi, tha se ku po i gjejnë këto ankesat opozita, pasi që edhe ne jemi ne Gadime dhe nuk po ka asnjë ankese, po edhe nëse ka ne jemi ne kontakt dhe ju përgjigjemi.

Arsim Jashari, tha se na jemi ne demokraci, dhe dikush e ngrit ndonjë shqetësim te unë dikush te ti?

Alban Salihu, tha se atë që e kemi thënë që disa herë në kuvend që po bëhen disa keqpërdorime dhe këtë e vërtetoi edhe prokuroria ku u arrestuan 7 zyrtarë para disa dite, ku ata po hetohen për keqpërdorime.

Daut Azemi, tha se ju kisha lut që te jeni ne pyetje te anëtarëve e jo ne diskutime, pasi që këtu nuk është gjykatë, respektoje rregulloren.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës së Lipjanit tha, se pari është mirë me nejt ne mbledhje jo me ikë nga mbledhja kur bënë diçka te tillë si kjo me këto sjelljet tua . E para prezumimin e pafajësisë duhet ta kemi prioritet dhe nuk mund ta shpallim askënd fajtor pa verdiktin final të Gjykatës. Çdo hetim është i mirëseardhur dhe un nuk marr te drejtën me interferu punën e gjyqësorit as me gjykuar. E dyta ky kuvend ka një agjende dhe një rregullore qe duhet me ju përmbajtje. Mos paragjykoni pasi qe ka pas edhe me herët arrestime por sot janë kthyer në punë. Çfarë të mire keni bërë ju si VV për qytetarët e komunës së Lipjanit. Unë them qe janë zhvilluar dy faza të stadiumit por do të zhvillohet edhe faza e 3-të. Po ta kishi ju hallin e popullit do te dilshi dhe do të thoji hallall ju koftë zyrtareve të komunës së Lipjanit qe i fituan disa çmime si komuna e parë dhe e dytë nga disa organizata, vendore dhe ndërkombëtare.

Albiona Tasholli, tha se te vetmin ju VV-ja, qe nuk i shihni te mirat qe janë punuar ne komunën e Lipjanit nga ekzekutivi i komunës, e ku ka shumë të mira siç janë ndërtimi i sallave të sportit, ndërtimi i çerdheve ndërtimi i shkollave të reja, hapja e rrugëve të reja, objekti i ri i komunës e te tjera projekte të mëdha.

Daut Azemi, tha se anëtarët e kuvendit të cilët flasin nga vendi do te përjashtohen nga mbledhja.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se edhe unë kam vërejtje për anëtarët qe po flasin nga vendi, por edhe ju si kryesues duhet te jeni i barabartë me të gjithë. Ne si kuvend e kemi themeluar një komision për përzgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendës drejtoreve te shkollave, dhe kërkoj qe me pru ne kuvend një raport nga ky komision për shkak se ka shkelje te procedurave sipas disa kandidatëve në konkurs.

Lulzim Rrustemi, tha se pari duhet te ketë rend dhe disipline ne kuvend dhe është mirë qe kuvendi ka pozitë dhe opozitë. Ne para disa viteve kemi ngrit shqetësimin se ka keqpërdorime ne komunë, dhe çdo keqpërdorim apo lëshim duhet te publikohet. I kam 3 pyetje po flitet qe po përgatitet një deponi e mbeturinave regjionale në Lipjan, apo bëhet ajo deponi? E dyta sa i përket programi MCC, çka po ndodh me ndërtesën ne sheshin Adem Jashari, te barnatorja e qytetit qytetarët po pyesin se çka po ndodh me ndërtesën e tyre, pasi qe ata i kanë dhënë nënshkrimet. E treta çka ka ndodh me një vendim qe kemi themeluar një ndërmarrje ne Kuvend deri ku ka shkuar kjo çështje.

Shahadije Bikliqi-Daragçina, tha se kam disa kërkesa të qytetarëve e para të banorëve të rrugës Blini në Gllgovc qe kërkojnë asfaltimin e rrugës së tyre duke e lidhur me rrugën kryesore. E dyta ka të bëj me familjen Berisha nga Janjeva për

ndërtimin e një ure mbi lumin në Janjevë. E treta ka të bëjë me transportin në Janjevë që e kam ngrit disa herë.

Egzona Bytyqi, tha se pari kërkoj që në kuvend të paktën niveli i kulturës të jetë në nivel. Kam disa pyetje në kemi bërë bojkot për ndalimin produkteve serbe, por ju si komunë a keni ndërmarr ndonjë veprim që të ju ndihmohet kompanive vendore që të kemi produkte sa me cilësore. Sa i përket shëndetësisë, sa është numri i të vaksinuarve me gripin sezonal sa po kemi kapacitete që të ju dal në ndihmë këtyre qytetarëve. E treta në shtator pritet të bëhet regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familje, a keni marr të gjitha veprimet ju si komunë sa i përket kësaj çështje. Dhe e fundit tani jemi në zezonën e dimrit, a janë marrë të gjitha përgatitjet në rast se kemi probleme me rrugë dhe rrugica në rast të reshjeve të borës.

Herolind Kozhani, tha se situata në të cilën po gjendemi ka një imazh të keq jo vetëm për vendin tonë por për tër Kosovën, por zyrtarët të cilët u arrestuan nuk duhet të e përmenden vetëm për keq pasi që këta zyrtar janë që kanë punuar dhe janë fituar disa çmime nga këta zyrtar.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha se pari ju them se hiqeni krejt nga rendi i ditës pyetjet e anëtarëve të Kuvendit, por bene një pikë debat në Kuvend pasi që nuk po respektohet kjo pikë. Ne do të vazhdojmë me punët e mira për qytetarët e komunës së Lipjanit. Dhe këta zyrtar nuk janë të emëruar publik, ete cilat kanë qenë disa me herët se unë me u bë kryetar komune në punë e disa pasi që jam ardhur unë. Dhe këta zyrtar nuk kanë as aktakuze, por janë vetëm të ndaluar. Sa i përket deponisë komuna jonë nuk ka dhënë pëlqim për deponi e as nuk do të jep. Sa i përket objektit konkret nuk i kemi ende burimet e financimit dhe do të kryejmë besojmë. Ende nuk kemi marr asnjë përgjigjeje për ndërmarrjen komunale nga Komisioni i Ministrisë. Sa i përket disa rrugicave ka nevojë por proceduar e kontraktimit nuk janë të lehta, por edhe disa rrugë janë regjionale dhe në nuk mund të vendosim pengesa në rrugë. Shtrati i lumit në Smallushë është projekt 2 vjeçar dhe do të kryhet edhe pjesa e cila ka mbetur. Sa i përket konkursit në DKA në ende nuk kemi marr asnjë ankesë.

Ardit Cani, tha se i kam disa kërkesa të qytetarëve e para ka të bëjë me rregullimin e trotuarit me ndriçim publik në Risinovc dhe Bance, po ashtu rregullimi i shtratit të lumit si dhe vendosja e shenjave që ndalon kalimin e kamionëve me pesha të rënda.

Rinor Murati, tha se i kam dy kërkesa e para ka të bëjë me subvencionimin e bujqve me plehra artificiale pasi që çmimi aktual i plehut është i lartë. Dhe e dyta, sa

i përket furnizimit me uniforma në Gjimnazin e Lipjanit, do të ishte mirë që një angazhim të tillë ta kenë edhe shkollat tjera.

Xhuzide Rrutemi, tha se kam disa kërkesa të qytetarëve të Banullës e para të vendosen pengesa në rrugë nga kolegji Mehmet Akif deri te udhëkryqi i Janjevës për shkak të shpejtësisë së madhe të lëvizjes nga veturat. E dyta të bëhet vendosja e një stacioni për pritjen e autobusëve në magjistrale Prishtinë Ferizaj të rruga e Bnaullës. Ti bëhet një zgjidhje objektit të vjetër të shkollës në fshat. Të bëhet ndertimi i disa urave mbi lumin e fshatit Banullë. Të bëhet mbishkrimi që tregon ku është fshatin Banullë dhe në fund të bëhet ndriçimi publik në lagjen Abdullahu dhe lagja Jashari.

Bashkim Budakova, tha se nëse doni ti merrni meritat kur bie shi duhet ti barti përgjegjësinë kur merr thatë. Pyetja ime rreth lumit Sitnica a keni ndonjë projekt?

Alban Salihu,tha se në stadiumin e Magures janë bërë disa investime dhe aty ka keqpërdorime. A do të përfundohet stadiumi i Magures ose jo.

Arsim Jashari, tha se pari atyre zyrtareve që janë në ndalese në nuk jemi duke ja bërë gjykimin ,por në jemi vetëm për fazën e parë, dhe askush nuk është duke ia bërë gjykimin atyre zyrtarëve pasi që edhe ata kanë familje.

Daut Azemi, tha se kemi pas edhe me herët raste të arrestimeve në komunë nuk janë rastet e para.

Lulzim Rustemi, tha se ky debat për ngjarjet e fundit duhet përgjegjësi politike, pasi që stadiumet në Mgaure dhe Dobraje janë në gjendje shumë të keqe. Tha se e kam edhe një propozim që të ju ndihmohet qytetarëve në Mitrovicë dhe Skenderaj me një shumë prej 100 mijë eurove për shkak të vërshimeve të fundit.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, kemi kompani të pastrimit të mirëmbajtjes dimërore , në Kleçkë është intervenuar disa herë ndërsa në vendet tjera nuk ka pas nevojë. Por mos të harrojmë që kemi edhe rrugë regjionale të cilat menaxhohen nga Ministria. Regjistrimi i popullatës është formuar komisioni sipas pozitive që ka caktuar ligji. Ndihma në Skenderaj dhe komunat tjera kam qenë i kam vizituar por nuk kemi mundësi të kapaciteteve buxhetore si me ju ndihmuar,unë jam për të ju ndihmuar por jo shumë sa u me herët. Në kemi kërkuar që të kemi edhe një fond emergjent por nuk na është lejuar nga Ministria.

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 14-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shahadije Bikilqi, tha se e kam një vërejtje pasi që janë disa fjalë të pa kuptimta. Edhe vërejtje kemi pers allen e kuvendit që nuk i plotëson kushtet pasi që është ftoftë ne sallë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se na prej djepit i kemi lenë te lëshuar nxehjet 24 ore lëshuar. Ndërsa sa i përket ekstraktit shpesh po flasim nga vendi dhe nuk është e lehte te shënohen te gjitha.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se ne ekstrat nuk pat vërejtje, ndërsa sa i përket materialit do te mundohemi që mbledhjen e ardhshme te ua dërgojmë ashtu siç propozuat, pastaj vuri në votim ekstraktet nga mbledhja e 13 e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 29 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 14-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II.

Informata për punën e BKSB-së, për vitin 2022

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Diamant Bytyqi, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ata anëtar të cilët nuk marrin pjesë në KKSB, unë rekomandoj që te njoftohen ne lindja zyrtare dhe nëse nuk marrin pjese prapë te ndërrohen.Me vjen mire që janë përfshi ne plan te punës së KKSB-së, disa aktivitete te grupit te PDK-së, te cilat i ka propozuar doktoresha Egzona dhe propozime tjera nga anëtarët e këtij grupi.

Gentiana Hoxhoj, tha se KKSB-ja, po bën një punë shumë të suksesshme pasi që e ka një ekiye që përbehet ne përfaqësuesit e bashkësive fetare dhe ato te institucioneve dhe te komuniteteve te ndryshme, e ku ne këtë këshill janë diskutuar shumë teme e sidomos ajo e dhunës në familje.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina,tha se sa i përket kësaj informate kam një vërejtje për kryesuesin , ku thuhet se është mbajtur një mbledhje jashtë këtij këshilli dhe janë bërë disa vërejtje por nuk ceken ato në këtë këshill. Po ashtu ka vërejtje për disa anëtar të këtij këshilli të cilët mungojnë por edhe kur janë nuk flasin asnjëherë. Po ashtu ceket që kanë dështuar dy aktivitete njëri për qentë endacak dhe tjetri për zjarrfikësit.

Egzona Bytyqi, tha se sa i përket informatës së KKSB-së, disa çështje që janë diskutuar atje i kemi diskutuar edhe në Kuvend,po ajo që është shqetësuese pasiviteti i përfaqësuesve të Bashkësive Fetare dhe të komiteteve,por pres që ata të reflektojnë tash e tutje. Po ashtu problematike janë qentë endacak. Unë e kam edhe një propozim prerja e drunjve ilegal.

Fadil Spahiu, tha se sa i përket raportit të Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, duket të jetë i detajuar deri në imësinat e aktiviteteve të anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Por, duke u bazuar në këtë Raport, shprehi keqardhje për anëtarët që nuk kanë dhënë kontribut në përpjekje për përmbushjen e detyrave të planit të punës, duke mos diskutuar dhe mungesa e vizionit për dhënien e ideve të reja për planin vjetor të punës dhe mos pjesëmarrja në hartimin e Raportit të Planit Vjetor të Punës. Andaj u bëj thirrje anëtarëve që deri më tani kanë qenë pasiv të aktivizohen për të kontribuar në realizimin e aktiviteteve për ngritjen e nivelit të sigurisë së qytetarëve në komunën tone.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha në KKSB paguhen vetëm ata që nuk janë në marrëdhënie pune, sa i përket pasivitetit të anëtarëve të KKSB-së, ne kemi edhe dy anëtarë të cilët do të zëvendësojmë. Në këtë informatë kemi paraqitur punët brenda një viti. I falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar që ky këshill të bëjë punën sa më të mirë. Po ashtu e kemi bërë edhe Planin e punës së KKSB-së, ku kemi marrë aktivitete të ndryshme nga bashkësia Islame dhe disa anëtarë tjerë. Prerja ilegale e pyjeve dhe ky një aktivitet i mirë të cilin do ta diskutojmë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi dha pauzë nga ora 12:00 deri në ora 13:30.

III

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2022, deri më 16.01.2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Latif Ramadani i cila i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj kryesuesi, hapi diskutimin?

Armend Grajqevci, tha se e përgëzojmë drejtoratin për raportin shkak për këtë janë edhe projektet e fituara vitin e kaluar nga komuna e Lipjanit, por në këtë raport dihet disa projekte që kanë mbetur pa u kryer për shkak të mungesës së OSHP-së, por edhe për kundër këtyre vështirësive komuna e Lipjanit ka arritur ta harxhojë buxhetin mbi 86% që është një përqindje e kënaqshme.

Lulzim Rrustemi, tha se me herët kemi thënë jemi në pozite të keqe dhe vështire do ta kemi ta realizojmë buxhetin, dhe kemi vetëm 86% të buxhetit të realizuar dhe është shumë pak. Të garantit qeveritar kemi suficit mbi 1 milion euro, po ashtu të të hyrat vetanake edhe ato të bartura kemi një shpenzim shumë të vogël. Të buxheti sipas kategorive ekonomike edhe këtu kemi buxhet të vogël të shpenzuar, Të subvencionet kemi pak me mirë buxheti i shfrytëzuar. Të shëndetësia nuk është mirë. Të pagat pse suficit afër 600 mijë euro pse? Të investimet kapitale edhe këtu kemi nën 50% të buxhetit të pa shpenzuar. Në përgjithësi kemi një buxhet të shpenzuar pak dhe ka nevojë për diskutim. Të disa drejtorate si Shërbimet Publike dhe Shëndetësia kemi një shfrytëzim jo të kënaqshëm. Të drejtorati për Kulturë kemi shpenzim zero, po ashtu edhe të Arsimit kemi shumë të vogël të shpenzuar. Në përgjegjësi të gjitha drejtoratet ka shumë mjete të pa shpenzuara nga garantit qeveritar e të cilat më nuk kthehen. Po ashtu ka edhe shumë projekte të cilat nuk janë realizuar të shumë rrugëve kanalizimeve e të tjera. Të të hyrat vetanake kemi një sukses. Ngecjet i kemi qiraja nga objektet publike, legalizimi i objekteve dhe tregjet e hapura. Të karburantet kemi rritje po ashtu edhe të riparimet automjeteve. Cilës kategori i dedikohet përfituesit individual. Ne si grup i PDK-së nuk jemi të kënaqur me këtë shpenzim të buxhetit.

Alban Salihu, tha se sa kesh në pauzë pata një kërcënim nga asamblesiti i LDK-së, Fitim Shala, të cilin e denoncova në polici?

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha nuk keni nevojë me keqpërdor foltoren e kuvendit për kështu raste, edhe nuk ka nevojë me i bërë gjërat tragjike pasi që ju jeni koleg në mes vete dhe unë nuk lejoj askënd me hy në kuvend me arrestua anëtar të kuvendit.

Fitim Shala, tha se, nuk është e vërtetë që e kërcënova anëtarin e VV-së, Albanin, por dola jaht dhe ju thash mos hyr në gjëra personale asgjë më shumë, e me këtë mund ta dëshmoni edhe përmes kamerave të sigurisë.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se, e para ju secili e njihni njëri tjetrin dhe rasti në fjalë ke krejt politik dhe mos e përdorni çdo fjalim për politikë po respektoje rregulloren e kuvendit bisedoni qetë dhe me argumente.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha, keni të paktën kulture të komunikimit e ju kulture të rrugës. Dhe jo çdo fjalim nuk o kërcënim.

Besiana Sylja, tha se siç po shihet nga ky raport buxheti është shpenzuar vetëm 84% e jo siç është paraqitë 86%. Dhe te shpenzimi i buxhetit kemi një shifër jo të mirë te buxhetit të shpenzuar. Te garanti qeveritar siç po shihet komunës i kanë shkuar suficit afër 2 milion euro për këtë kam paralajmëruar edhe në seancat e kaluara që kjo gjë do të ndodhe dhe ja që ndodhi. Sipas kategorive ekonomike edhe aty kemi suficit si dhe në mallra dhe shërbime, komunalit dhe investime kapitale. Kemi një menaxhim jo te buxhetit. Te ky raport shihet që shumë projekte nuk kanë filluar hiç apo kanë mbetur në gjysme. Komuna e Lipjanit e ka pas edhe një garantit që e ka shfrytëzuar me pak se gjysmën dhe nuk e di ato mjete a do të barten prej garantit të performancës.

Egzona Bytyqi, tha se sa i përket raportit të buxhetit unë do të ndalem te drejtorati i shëndetësisë , e sidomos te blerja e aparaturave shëndetësore, blerja e aparaturave shëndetësore, jam kureshtar se destinimin e saktë të tyre. Te fshati Qylagë, asnjë projekt i vetëm nuk është realizuar gjatë këtij viti.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se në çdo raport kemi ekzekutimin nga thesari që na dhemb të gjithëve, e ku me këtë po na dëmtohen edhe projektet në teren për shkak të marrjes së mjeteve. E kam një pyetje kur komuna do të planifikoj pagat jubilarë për punëtorë pasi që punëtorët po duhet me ju drejtuar Gjykatave për ta fituar këtë të drejtë. Pse komuna nuk është e drejtë me të gjithë, pasi që punëtorët e Komunës i kanë marrë afër 100 euro të pagës jubilarë ndërsa punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë duhet me ju drejtuar gjykatës. Shpërblimet që po ju epën punëtorëve të administratës ndërsa te tjerave jo, pasi që është e pa drejtë.

Nexhmedin Lekiqi, tha se sa e spejgoj drejtori raportin të gjithë e dëgjuam , dhe si e përfundoi drejtori pat pyetje, e te cilat u përgjigj gjatë shpjegimit. Një ditë ne kemi me pas stadione por nuk kemi njerëz për me luajtur aty. Dhe e fundit që 1 vit ne kuvend ende asnjë anëtar nuk u përjashtua nga Kuvendi.

Arsim Jashari, tha se, kur flisni mos i përfshini të gjithë, se ne secili kemi obligim ndaj qytetarëve.

Latif Ramadani, tha se nuk kemi mujt me pas shpenzim ma të madh për shkak se sna kanë lejuar organizatat tjera, ka munguar OSHP-ja, dhe shumë projekte nuk janë kryer për shkak të saj. Ne buxhetin e kena aprovua ne Kuvend, por alokimin e mjeteve nuk na ka lejuar ministria dhe për ata janë vonuar projektet. Asnjë projekt nuk është kryer pa pas zotim të mjeteve dhe për këtë e them me përgjegjësi të plotë .

Kemi votuar dy here ridestinimin e mjeteve dhe ministria nuk na ka lejuar. Po ashtu ka dashtë kjo qeveri edhe te hyrat vetanake me na i marr. Shërbimet kontraktuese janë mirëmbajta e lumenjve, e rrugëve, ndriçimi publik e të tjera. Ne në secilin drejtorat i kena planifikuar mjetet për personat që dalin në pension po nuk na kanë lejuar ministria. Në QKMF, kemi ndarë mjete këtë herë me shumë. Shëndetësia dhe arsimi po duhet me gjykate pasi që me ligj nuk po na lejohen e jo që nuk po dimë me i planifikuar

Besiana Sylja, tha se, unë çdo muaj e marr raportin e lexoj çdo detaj, dhe mos te ju jetë hatri pse na po ju kritikojmë, ju punoni më mirë na nuk ju kritikojmë. E dyta çdo komune Ministria ja ndan buxhetin dhe ku i dërgoni mjetet prej juve varet.

Latif Ramadani, tha se nuk ka funksionuar OSHP-ja, dhe për atë disa projekte nuk kanë përfunduar. Mjetet e performancës barten në vitin vijues.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se pyetja ime ke, a i kanë marrë punëtorët e administratës komunale ka 100 euro të pagës jubilarë ose jo?

Shahadije Bikliqi-Gragaçina, tha se, nuk është e drejtë me ndërhy drejtoreshat prej vendit kur bisedojmë ne.

Daut Azemi, kryesues i kuvendnit tha se po ju shikoj te gjithëve që nuk po e respektoni njeri tjetrin kur po flet, por kjo është mos kulture e komunikimit nga ana juaj.

Alban Salihu, tha se ju keni thënë që punimet në stadione do të kryhen këtë vit, ku do ti merrni mjete që me u përfundua këto stadione ?

Latif Ramadani, tha se po punëtorët e administratës i kanë marr mjete e pagës jubilarë .Po do ti përfundojmë të gjitha stadiumet, pasi që kemi mjete për ti përfunduar. Te hyrat dhe donacionet do të barten vitin tjetër.

Arsim Jashari, tha se sipas zëdhënëses së komunës të një deklarate publike të saj ka thënë se stadiumi në Dobarjë a ka përfunduar, a ka përfunduar ose jo stadiumi në Dobarjë.

Lulzim Rrustemi, te përfituesit individual nuk na treguat kush janë, dhe për paga janë shkuar 600 mijë euro suficit pse kaq shumë

Latif Ramadani, pagesat individuale janë ato për bursa për praktikantë. Stadiumet do të kryhen te gjitha.

IV

Propozim-vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2023-2027 (Rishikim).

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Imri Smetishti i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Albiona Tasholli, tha se sa i përket planit i cili është miratuar ne seancën e kaluar te kuvendit, përfundoj duke u kthyer prapë nga ana e ministrisë e mjedisit duke kërkuar harmonizimin, kjo kërkesë është e pa baze nga ana e ministrisë dhe mënojmë qe ky vendim është vendim politik dhe kërkojmë qe te ketë bashkëpunim ma te mire me komunat.

Arsim Jashari, tha se ne si Grup i PDK-së, si plan e mbështesim. Edhe e kam një pyetje mos po i kthejnë për shkak teje qeto, a ju kane kthyer ma herët edhe drejtorit të më parshëm, pasi qe nuk ka pas asnjë arsye ky vendim me u kthyer. Na nëse vazhdojmë kështu me na kthye vendimet nuk është në rregull.

Imri Smetishti, a janë kthyer ne ketë permasë me herët vendime kështu nuk e di, por ne kemi mospajtime të theksime me këtë ministri dhe nuk i kam kursyer me asgjë me argumente, a kanë diçka personale nuk e di. Por nuk besoj qe kane me na u kthyer me tutje.

Arsim Jashari, tha se do ta keni ta keni mbështetjen çdoherë për të mirën e qytetarëve si grup i PDK-së.

Imri Smetishti, ky plan nuk ka nuanca politike por po bëhet për të mirën e qytetarëve.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me ndryshimet e cekura me lart, dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 3 abstenime aprovoi Vendim

V

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Kompaninë Rajonale të Mbetjeve "Pastrimi" Sh.A.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Valon Pacollit i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 3 abstenime aprovoi Vendim

Rinor Murati, tha se sa i përket këtij propozimi ne emër të grupit të LDK-së, e mbështesim por duke shpresuar qe propozime për pagime te borxheve me mos te kemi nga kjo kompani.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha ne emër të grupit të PDK-së e mbështesim këtë propozim vendim. Por kërkojmë nga aksionaret e komunës qe te mos rritet barra për qytetarët e komunës së Lipjanit për çmimin e faturës se mbeturinave.

Daut Azemi, kryesues i Kuvendit, tha se mendimi jonë edhe i aksionarëve është qe të mos ketë rritje të çmimeve të faturës së mbeturinave.

Lulzim Rrustemi, tha se është mirë qe bordi me kërkuar raport financiar prej kompanisë pasi qe i ka kompania dy kontrata me komunën dhe duhet raport financiar.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, 4 abstenime aprovoi Vendim

VI

Propozim Vendim për lirimin nga pagesa të borxheve jofitimprurëse të qirasë të përfituesve të banesave sociale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdini drejtor i DSH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se e mbështesim këtë propozim vendim, por dëshirojmë te dimë mos është bërë ndonjë komision për me i përcjellë se mos ju ka ndryshuar gjendja këtyre familjeve. A janë shpërnda të gjitha banesat qe janë funksionale

Fadil Spahiu, tha se Duke u bazuar në arsyetimin e këtij propozim Vendimi të përshkrimit të gjendjes së rëndë sociale të këtyre familjeve dhe qëllimin e lehtësirave financiare për këto familje, pas krijimit të situatës së rënduar ekonomike me ngritjen e çmimeve të të gjithë artikujve elementar jetësor në vendin tonë, vërtetohet se është e vështir të bëhen pagesat e rregullta. Pra, ne mbështesim fuqishëm këtë Propozim Vendim për lirim nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të këtyre familjeve përfituese të banimit social

Arsim Jashari, tha se a janë nda këto banesat e fundit a hale?

Lulzim Rrustemi, tha se është mirë që ato familje që kanë fëmijë mbi moshën 18 vjeçare, që fëmijë të tyre me shti dikun me punë sekondare, ose punë praktike.

Shkelzen Hajdini, tha se nuk është bërë asnjë komision për vlerësim, kontratat janë 5 vjeçare dhe ata e vlerësojnë gjatë vazhdimit nëse kanë ndryshuar diçka ose jo. Të gjitha banesat janë funksionale. Sa i përket banesave të reja komisioni është duke punuar dhe nuk është marr asnjë vendim. Me këto familje do të shohim mundësinë e angazhimit

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi vendimin

VII

Raport i punës së Komisionit për organizimin dhe koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Majlinda Sylejmanit, kryesues e , Komisionit për organizimin dhe koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit. i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Daut Azemi, tha e përgëzoj komisionin për punën që kanë bërë edhe pse nuk ka qenë proces i lehtë e ku ju përgëzoj të gjithë anëtarët për kontributin e dhënë.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Rinor Murati, tha se i falënderoj komisionin për punën që kanë bërë, po ashtu edhe qytetarët për pjesëmarrje. Vlen të theksohet që komuna e Lipjanit është ndër komunat e para që e ka kryer këtë proces.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ,unë kam qenë në mandatin e kaluar në këtë komision dhe e di sa sfiduese ka qenë puna,unë e përgëzoj komisionin për punën e

mirë që e kanë bërë. Po me vjen mirë që është zgjedh një grua kryetare e fshatit por për me vjen keq që është zgjedh vetëm një grua.

Bashkim Budakova, tha cila është arsyeja pse nuk është zgjedh kryetari i këshillit në fshatin Rubovc.

Arsim Jashari, tha se në këshillin e fshatit nga vij unë në Banullë janë disa femra në këshill, por si duket ne i kemi fajet pasi që duhet të dalim nga petku patriarkal dhe ka nevojë që të ketë më shumë femra në vendimmarrje.

Ganimete Qeriqi, tha se Pëshendetje!

Unë kam qenë në mandatin e kaluar anëtare e komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave. Unë kam vërejtur disa rreziqe, vullneti i qytetarëve nuk ka qenë i lirshëm as mes burrave, e për gra hiç se hiç. Integrim i grave dhe vajzave zero ose si çmimi i një artikulli 99.999, që ska as monedhe për kusur. Aty ku ska integrim të grave dhe vajzave s,ka liderizëm as ardhmëri. E këtë po e tregon rezultati dhe % e këshillave të fshatrave .Në këto zgjedhje të këshillave të fshatrave ka pasur një ekstremizëm popullist. Në ato fshatra ku kanë synuar se nuk kanë mundësinë të zgjedhur njeriun e vet ,që e kanë joshur me pak diçka ,zgjedhjet i kanë ndërpre e kanë pasur këtë mekanizëm në dorë ,kur dojnë m,i ndërpre e kur dojnë m,i vazhduar...Arritje profesionale të të gjitha niveleve ka edhe të gratë dhe vajzat. Partina pushtet ska pasur interesim për avancim të gruas. Duhet popullit me ja mësuar sytë me parë edhe gratë dhe vajzat në udhëheqje në nivel bazik. Kombi ynë ka pasur njerëz me vizion e vlera por politikat e tashme po i rrënojnë për arsye personale. Për këto zgjedhje të këshillave të fshatrave metet me u pershendet veç fshati Shalë, ndoshta është merite e drejtoreshës Safete.

Lulzim Rrustemi, tha se,na për këtë angazhim duhet të jemi të kënaqur edhe pse nuk kemi qenë të gjithë sa duhet të angazhuar dhe kemi mujt me dalë edhe më mirë por nuk jemi edhe keq prapë. Dhe këta këshilla të fshatrave do të epin kontributin e tyre tani e tutje. Ne grackë kemi pas kërkesë që të bëhen dy këshilla një për shqiptar dhe një për serb ne ju kemi dhënë mundësinë për 1 javë me ardh dhe ata nuk kanë marr pjesë serbet si duket nuk kanë pas interesim.

Daut Azemi, tha se sa i përket Grackes aty komuniteti shqiptar nuk ka kërkuar me pas kryetar por vetëm me qenë në këshill, mirëpo komuniteti serb tani nuk ka marr pjesë hiç .

Majlinda Sylejmani, tha se ne fshatin Rubofc e kemi caktuar takimin e parë dhe nuk ka marr pjese askush pastaj e kemi caktuar prapë edhe takimin e dytë ka fundi, e kemi publiku orarin me kohë dhe ka qenë një pjesëmarrje shumë e vogël prej 8 apo 9 persona dhe ky fshat njëherë ka mbet pa këshill.

Lulzim Rrustemi,tha se komisioni ka mandat dhe do ta kryejmë edhe Rubofcin. Dhe e fundit pagesat qe po jemi ne komisione duhet te bëhen pasi qe ne kemi vendim te kuvendit per pagese.

VIII

Deklarata e Kuvendit të Komunës në mbështetje të kërkesës së qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", që lulëkuqja me katër petale të jetë simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga deklarata.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi deklaratën.

IX

Rekomandim qe te pezullohen vendimi për rivlerësimin e tatimit në pronë për vitin 2023,dhe të bëhet faturimi i tatimin në pronë siç ka qenë në vitin paraprak 2022.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Rekomandimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha pasi qe tatimi në pronë është kompetencë e komunës ne kërkojmë qe të bëhet falja prej 100 eurove qytetarëve të komunës së Lipjanit.

Daut Azemi, tha se ne nuk kemi bazë per me falë tatimin por duhet me pas vendim nga niveli qendror pasi qe ne nuk kemi mundësi me falë.

Ltaif Ramadani, na si asociacion i komunave kemi reaguar dhe kemi kërkuar qe te kthehet ashtu siç ka qenë dhe kjo është kompetencë nivelit qendror. Dhe me këtë shumë ju ka vështirësuar puna qytetarëve.

Alban Salihu, tha se disa komuna do ta bëjnë faljen e tatimit dhe do ta gjejnë mënyrën ligjore. Por ju si komunë kur janë bërë vlerësimet a keni dërguar ndonjë rekomandim ju si komunë.

Arsim Jashari, tha se ne si grup e mbështesim këtë rekomandim qe është edhe rekomandim i asociacionit të komunave. E dyta ne nuk kemi bazë ligjore me ndërpre. Dhe treta Grupi i deputeteve te PDK ne nivel qendror e ka dërguar një rekomandim për këtë ligj.

Latif Ramadani, tha se jo nuk e ka bër asnjë komune faljen dhe ne si komune kemi ekipin me te mire te tatimit ne pronë në të gjithë Kosovën. Ne nuk kemi te drejtë ta falim këtë tatim si komunë.

Arsim Jashari, tha se ne nuk kemi asnjë të drejtë me fal borxh, dhe nëse Ministria merr një vendim te tillë do te bënte shumë keq

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për, 3 abstenime ,aprovoi deklaratën.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 16:20

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi